



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAÇKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 666 / 2017  
Datë: 26 dhjetor 2017

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr.03/ L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 26 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Miratohet kërkesa e prokurorës së Prokurorisë Themelore në Pejë, znj Ardita Beqiraj - Hyseni, për lejimin e pushimit pa pagesë për periudhën gjashtë (6) mujore, nga data 1 janar 2018 deri me 30 qershor 2018.
- II. Znj. Ardita Beqiraj - Hyseni, duhet të fillojë punën me datë 01 korrik 2018, nëse nuk ndryshojnë rrethanat dhe nëse nuk nxirret ndonjë vendim tjetër për këtë çështje.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

**Arsyetim**

Me datë 07 dhjetor 2017, prokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë, znj Ardita Beqiraj - Hyseni, ka paraqitur kërkesë për lejimin e pushimit pa pagesë në afat prej 1 viti, duke filluar nga muaji Janar 2018. Në kërkesë prokurorja ka treguar se arsye e kërkesës është ngritja profesionale pasi që do të vazhdoj studimet master në Gjermani.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pasi që shqyrtoi këtë kërkesë, duke vlerësuar se për të njëjtën është pajtuar Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, z. Agim Kurmehaj, duke pasur parasysh që në këtë prokurori është duke u plotësuar numri i nevojshëm me prokurorë, si dhe interesit edhe të sistemit prokurorial që prokurorët të jenë sa më të përgaditur profesionalisht, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Blërim Isufaj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj Ardita Beqiraj - Hyseni;
- Kryeprokurorit të Pth Pejë;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Njshpp;
- Arkivit të KPK-së.